



Si të përfitonit pagesa direkte në bujqësi.
- Kriteret e reja/
Grupimet e fermerëve të favorizuar

Faqe 3

TVSH-ja për fermerët mbetet "pezull" -
Debate në Komisionin e Ekonomisë mbi propozimin e Braçes

Faqe 3

Kredi të lira për bujqësinë - Drejtoresha e AZHBR: Interes i lartë nga fermerët. Garancia sovrane? Gati në mes të vitit

Faqe 5



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit shkurt 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 504
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

FINANCIM I DREJTPËRDREJTË PËR FERMERËT DHE BLEGTORËT SKEMA KOMBËTARE 2025, DENAJ: RISI FINANCIMI PËR MBARËSHTIMIN E VIÇAVE, NGA SKEMA E NAFTËS MBI 50 000 PËRFITUES

Qeveria përmes Skemës Kombëtare në Bujqësi, adreson subvencione për fermeret duke i mbështetur ata në uljen e kostove dhe nxitjen e potencialit të prodhimit bujqësor vendas. Kriteret për përfitim nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2025, janë botuar në Fletoren Zyrtare, ku dhe është përcaktuar vlera e saktë që do të përfitojnë aplikantët fitues sipas kulturës së mbjellin, krahas financimit për naftën që përdorin për punime të mekanizuara në bujqësi

GO SP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



PORTRET

Kristaq Kola - Agronom me diplomë të artë, por me "cen" në biografi

Nga: Agr. Koço Mosko, Boston, SHBA

Faqe 11

TEMA TË DITËS

- Deri 186 euro/hektarë për naftën në bujqësi - Harta e mbjelljeve/ Sa para do të marrin fermerët sipas kulturës? Fq.2
- Aplikimet për kullotat verore - Në Tepelenë, 20 mijë ha kullota dhe 1 mijë ha pyje Fq.2
- Rrugë të reja në Alpet e Shqipërisë - BERZH hap tenderin, përmirësim i aksesueshmërisë dhe infrastrukturës së turizmit të aventurës Fq.5
- Dilemat në kultivimin e misrit për vitin 2025 Fq.10
- Kalendari bujqësor, muaji mars 2025 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

Turqia asistencë për zhvillimin e sistemit të sigurimeve në bujqësi



Faqe 2

AZHBR

AZHBR dhe agjencia homologe kroate, marrëveshje për ekspertizë në thithjen e fondeve të BE-së



Faqe 2

INTERVISTA

Banka Shqiptare e Zhvillimit, Ekonomi për ATSH: Mbështetje integritetit të SME-ve në tregun e hapur europian



Faqe 6

TEMA TË DITËS

AZHBR dhe agjencia homologe kroate, marrëveshje për ekspertizë në thithjen e fondeve të BE-së

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe agjencia homologe kroate (PAAFRD) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në Zagreb, Kroaci, e cila synon

Marrëveshja parashikon organizimin e përbashkët të konferencave, seminareve dhe trajnimeve për menaxhimin e fondeve të BE-së, pagesat direkte, zhvillimin rural dhe

Rural (MBZHR) dhe Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme, Ardita Kuçi, zhvilloi një vizitë studimore pranë Agjencisë Homologe në Zagreb. Vizita studimore, mbështetur nga GIZ, pati për qëllim shkëmbimin e eksperiencave mbi sistemet për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të parcelave bujqësore (LPIS dhe ARKOD).

Delegacioni shqiptar u njoh me funksionimin e sistemeve të menaxhimit të pagesave (IACS) dhe monitorimit të aktivitetit bujqësor (AMS), duke marrë pjesë në disa trajnime praktike në zyrat qendrore dhe rajonale të PAAFRD.

Ky partneritet është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të shërbimeve bujqësore në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira europiane.



shkëmbimin e informacionit, eksperiencës dhe metodave të përdorura në zhvillimin e sistemeve operacionale për zbatimin e fondeve të BE-së.

masat e tregut.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, një delegacion i përbërë nga stafi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit

IPARD III, Ministria e Bujqësisë pret që “drita jeshile” të jepet në vitin 2026

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pret që “drita jeshile” për IPARD III të jepet në vitin 2026, duke u dhënë kështu mundësinë fermerëve të përfitojnë në 9 fushat që do të mbështeten me fonde, si infrastrukturë rurale, ndërtim tregjesh, për agropërpunim apo agroturizëm, pylltari, asistencë teknike e këshillim.

Ndërkohë është mbyllur lëvrimi i fondeve për fermerët përfitues nga IPARD II, që i takon periudhës 2014-2022, me një financim prej 94 milionë euro në total.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bën të ditur se, ka dorëzuar pranë strukturave të Komisionit Evropian (DG AGRI) në fund të 2024 një plan veprimi me masat e ndërmarra në strukturat e menaxhimit, metodat e zbatimit dhe kontrollin e brendshme, që janë të rëndësishme për të siguruar transparencën dhe efikasitetin e projekteve.

Sipas MBZHR-së, në korrik të këtij viti do të ketë një raport për realizimin e këtyre detyrave dhe në vjeshtën e po këtij viti (shtator-nëntor) do të

Financim i fermerëve dhe bujqësisë po vijon paralelisht me fonde nga buxheti i shtetit, përmes Skemës së Investimeve e prezantuar vjet, që do



auditohen masat e ndërmarra nga Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR.

Aktualisht pranë AZHBR-së është ngritur një sistem që bën verifikimin në kohë reale të aplikimeve të bëra.

të vijojë edhe këtë vit, Skemës Kombëtare me subvencione për bujqësi e blegtori si dhe programi i kredive të buta që pritet të jepen nga bankat pas miratimit të programit nga Banka e Shqipërisë.

Aplikimet për kullotat verore - Në Tepelenë, 20 mijë ha kullota dhe 1 mijë hektarë pyje

Në Bashkinë Tepelenë ka nisur faza e parë e aplikimeve për kullotat verore, një proces i rëndësishëm për blegtorët e zonës.

Në dispozicion janë vënë 20 mijë hektarë kullota dhe 1 mijë hektarë pyje, të cilat do të

përdoren gjatë sezonit të verës për ushqimin e bagëtive.

"Jemi akoma në fazën e marrjeve të kërkesave nga fermerët, pasi sipas udhëzimit të ministrit të Mjedisit, afati është data 10 mars për kullotat verore. Edhe pas kësaj date

vazhdojnë kërkesat nga njësitë administrative apo kërkesat e fermerëve në zyrën e Protokollit në bashki," tregon Gëzim Shehu, drejtues i Drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Tepelenë.

(Vijon në faqen 4)

Turqia asistencë për zhvillimin e sistemit të sigurimeve në bujqësi

Shqipëria dhe Turqia angazhohen të rrisin bashkëpunimin në fushën e bujqësisë.

Në Tiranë, u nënshkrua Plan i Veprimit për Zhvillimin e Sigurimeve në Bujqësi, mes zëvendësministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Arian Jaupllari si dhe homologut turk Ahmet Bağcı.

Pas nënshkrimit të Planit të Veprimit, delegacioni turk u prit nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj.

Denaj bëri të ditur se përmes Planit të Veprimit për Zhvillimin e Sigurimeve në Bujqësi, sigurohet ekspertizë dhe asistencë teknike nga pala turke, çka sipas saj do të çojë në forcimin e kapaciteteve institucionale shqiptare.

Ministria Denaj po ashtu

deklaroi se qeveria do të rrisë mbështetjen shtetërore për

rimesh më të qëndrueshëm dhe efikas, duke garantuar më



fermerët.

“Ky është një hap i rëndësishëm drejt një sistemi sigu-

shumë mbrojtje financiare për fermerët dhe zhvillimin e bujqësisë”, tha ajo.

Deri 186 euro/hektarë për naftën në bujqësi - Harta e mbjelljeve/Sa para do të marrin fermerët sipas kulturës?

Fermerët që punojnë tokën do të përfitojnë pagesa cash për naftën që përdorin për punime të mekanizuara në bujqësi. Kriteret për përfitimin nga skema Kombëtare e Subvencioneve janë botuar në Fletoren Zyrtare, ku dhe është përcaktuar vlera e saktë që do të përfitojnë aplikantët fitues sipas kulturës së mbjellin.

Konkretisht, referuar vendimit kulturat janë të ndara në tre grupe kryesore.

Sai takon kultivimit të bimëve

thekër, elb, foragjerë njëvjeçarë, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk. Dhe 8,802 lekë/ha për foragjerë shumëvjeçarë, bimë aromatike-mjekësore.

Në grupin e drufrutorëve, do të jepet pagesë për naftën për kultivimin e mollëve me 18,582/ ha, 15,648 lekë/ha për të gjitha llojet e frutave, ulli, agrume dhe vreshta si dhe 13,692 lekë/ha për arra, bajame, lajthi dhe gështenja të kultivuara si dhe 16,626 lekë/



të arave, do të jepen 18,582 lekë/ha për kulturat pranverore si misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum. 12,714 lekë/ha për bimët e lashta si grurë, tërshërë,

ha për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arnore.

Sa i takon grupit të tretë, kultivimit të perimeve, pagesat për naftën variojnë nga 14,670

lekë/ha për të gjitha llojet e perimeve të fushës sezoni i parë, përfshi shalqi, pjepër, luleshtrydhe dhe 16,626 lekë/ha për të gjitha perimet e serës, sezoni i parë.

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për të përfituar nga skema e naftës, janë që të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës; Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 1 ha, ndërsa madhësia e parcelave, me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha. Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet me vetëdeklarim.

Fermerët përfitojnë deri në 100% të vlerës, me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlllogaritjeve të bëra. Për sipërfaqen mbi 10 ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”. Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren.

Kultivimi i kanabisit industrial, Qeveria miraton zonat kadastrale ku do të lejohet mbjellja

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për zhvillimin e industrisë së kanabisit në Shqipëri. Sipas këtij vendimi, janë përcaktuar zonat kadastrale ku do të lejohet kultivimi i kanabisit për qëllime industriale dhe mjekësore.

Më herët, ministria Denaj sqaroi se zonat janë përzgjedhur në bazë të studimeve të mirëfillta dhe se në listë nuk

përfshihen zonat me bujqësi të zhvilluar siç është zona e Myzeqesë dhe ajo e Korçës.

“Janë 10 zona Kadastrale që janë përcaktuar në bazë të studimi dhe janë të mirë përcaktuara, dhe njëkohësisht në gjithë bashkërendimin e veprimeve, besoj që të gjithë udhëzuesit do ta përcaktojnë më së miri se si do vijojë procesi. Janë të gjithë Shqipërinë,

porkan një kriter të domosdoshëm, janë të përjashtuar të gjitha zonat me intensitet të lartë bujqësore. Janë zona bujqësore, që janë jashtë vëmendjes të zhvillimit aktual të bujqësisë intensive, dhe me një distancë nga shkollat, vendet e banuara, dhe gati 3 kilometra në distance ku bletaria sot zhvillohet”, u shpreh Denaj.

SUBVENCIONE

FINANCIM I DREJTPËRDREJTË PËR FERMERËT DHE BLEGTORËT

SKEMA KOMBËTARE 2025, DENAJ: RISI FINANCIMI PËR MBARËSHTIMIN E VIÇAVE, NGA SKEMA E NAFTËS MBI 50 000 PËRFITUES

Qeveria përmes Skemës Kombëtare në Bujqësi, adreson subvencione për fermeret duke i mbështetur ata në uljen e kostove dhe nxitjen e potencialit të prodhimit bujqësor vendas. Kriteret për përfitimin nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2025, janë botuar në Fletoren Zyrtare, ku dhe është përcaktuar vlera e saktë që do të përfitojnë aplikantët fitues sipas kulturës së mbjellin, krahas financimit për naftën që përdorin për punime të mekanizuara në bujqësi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj deklaroi se, qeveria ka miratuar një vendim të rëndësishëm për të gjithë fermerët e blegtorët përcaktimin e kritereve bazë dhe masën e financimit për të gjithë sektorët që mbështeten nga fondi i programit dhe zhvillimit rural, e thënë ndryshe, Skema Kombëtare e Subvencioneve.

Në deklaratën për mediet, pas mbledhjes së qeverisë, Denaj tha se “Skema Kombëtare e Mbështetjes së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, financon për gjedhët deri në 10.000 lekë për lopë ose

mëshqerra, 5.000 lekë për viçat, në ferma jo më pak se 10 krerë”.

Gjithashtu theksoi ministria, “për bagëtitë e imta vijon po e njëjta masë finan-

cimi 1200 lekë/krerë; Për bletarinë 1000 lekë/koshere; Për perimet/luleshtrydhen/rrush tavoline në serra, masa e financimit është 200 000 lekë/ha (jo më pak se 1 ha)”. Denaj deklaroi se, është rritur një masë financimi për kontrollin biologjik të dëmtuesve, ku 50% e vlerës totale të faturës tatimore do të rimburohet sërish nga Skema Kombëtare e Mbështetjes.

“Bimët aromatike dhe mjekësore vijnë në jenë në fokus të Skemës Kombëtare me 30.000 lekë/ha (jo më pak se 1 ha), si kriter prani-

mi. Fermat organike 100.000 lekë/vit dhe 200.000 lekë për çdo fermë të certifikuar. Certifikimi GLOBAL GAP 50% të vlerës totale të faturës tatimore. Ndërsa nga skema e naftës përfitojnë më shumë se 50 000 fermerë. Do të jetë e njëjta masë financimi në çdo vit, por do të rrisim elementët të kontrollit duke rritur masën e kontrollit sipas një metodologjie të re të riskut, që të përfitojë fermeri i cili e meriton, është ai që e punon tokën”, u shpreh Denaj.

Ajo tha se, Skema e Subvencioneve i bashkohet

Skemës së Investimeve që është miratuar vitin e kaluar dhe mbështet pesë sektorë, duke kontribuar në zgjerimin e financimit për fermerët dhe bujqësinë.

“Konkretisht, Skema e Subvencioneve 2025 konsiston në masa e financimit për të gjithë fermerët dhe blegtorët me një risi për të gjithë ata që mbarësojnë viça për majmëri”, tha Denaj, teksa solli në vëmendje se Skema e Mbështetjes 2024 solli risi mbështetjen 100% të fermerëve të bashkuar në një kontratë për prodhim dhe siguri ushqimore.



Fermerët do të kenë mundësinë që së shpejti të aplikojnë për pagesa direkte nga skema e subvencioneve 2025. Vendimi i qeverisë përcakton kriteret e reja, ku përmes disa masave do të mbështetet rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe ulja e kostot për fermerët.

Konkretisht do të jepet pagesë direkte për gjedhët, në vlerën deri në 10 mijë lekë/krerë lopë/mëshqerrë dhe deri në 5 mijë lekë/krerë viça për fermer/aplikant, me jo më pak se 10 krerë gjedhe.

1 200 lekë/krerë për të imtat, për aplikantët me jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi. Sa i takon bletarisë do të jepen 1 mijë lekë për zgjuar për fermer/aplikant, me jo më pak se 50 zgjoje.

200 mijë lekë për ha për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Në çdo rast nëse masa e përfitimit përgjysmohet për kalimin e kufirit të vendosur, për bashkimet e fermerëve, pagesat do të jepen në masën 100%.

Përfitojnë pagesë shtesë fermerët që përdorin kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj, luleshtrydhe). Masa e përfitim-

it është në 50% të vlerës totale të faturave tatimore për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se 30 mijë lekë për dynym, në rastin e dy mbjelljeve në vit.

Pagesa për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike, është në vlerën 30 mijë lekë/ha për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha dhe 100-200 mijë lekë për fermat organike.

Sipas vendimit, fermerët do të përfitojnë pagesa cash për naftën që përdorin për punime të mekanizuara në bujqësi,



Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për të përfituar nga skema e naftës, janë që të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/

ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës; Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 1 ha, ndërsa madhësia e parcelave, me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha. Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet me vetëdeklarim.

Fermerët përfitojnë deri në 100% të vlerës, me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlllogaritjeve të bëra. Për sipërfaqen mbi 10 ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”. Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren.

Propozimi i deputetit Erion Braçe për shfuqizimin e skemës së vitit 2018 të TVSH-së për fermerët e cila është 0% në blerje dhe 20% në shitje, ka ngjallur debate në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave. Kjo për shkak se Ministria e Financave, ende nuk ka një përgjigje konkrete për propozimin e bërë.

Florian Semani, Zv. Ministër i Financave: “Ne do studiojmë në mënyrë të përshtetshme skemën dhe do të kemi një përgjigje konkrete”.

Enkelelda Kuçi, Drejtor e Politikave Tatimore: “E vlerësojmë shumë ini-

ciativën, siç kemi thënë edhe më herët, patjetër që jemi të angazhuar për të shikuar në tërësi tatimin e vlerës së shtuar për sektorin e bujqësisë. Ligji që kemi në fuqi është në përputhje të pjesshme me BE, një pjesë e mirë e dispozitave janë të harmonizuara plotësisht. Pikërisht për shkak të rëndësisë që ka ky sektor ne kemi kërkuar asistencën e BE-së, për qëllime të trajtimit sa më të mirë për një skemë të përshtatshme për sektorin e



bujqësisë. Kërkesë që është pranuar nga TAIEX, në prill vjen misioni që të jemi në përputhje me BE-në”.

Por deputeti Erion Braçe e ka konsideruar tallje mungesën e një qëndrimi, duke u shprehur se TVSH në bujqësi çënon 45% të qytetarëve.

“Qeveria duhet të kuptojë se institucioni që cakton taksat është Kuvendi i republikës dhe jo qeveria. Qeveria duhet ta kuptojë shumë mirë këtë. E dyta është pavarësia e Kuvendit për të vendosur në interes të atyre njerëzve që votojnë për deputetët e Kuvendit. Pavarësia e Kuvendit nuk mund të cenohet nga asnjë ministër, dhe aq më tepër të rrëzohet brutalisht me vota kundër. Flasim për një çështje që cenon 45% të qytetarëve që impakton një sektor prodhues, që është sektori prodhues më i madh në vend. Për 500 mijë euro u shkatërrua skema e TVSH”.

Disa vite pas implementimit të kësaj skeme, ende nuk është bërë një analizë për dëmet që ka shkaktuar tek fermerët dhe në humbjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare.

TVSH-ja për fermerët mbetet “pezull” - Debate në Komisionin e Ekonomisë mbi propozimin e Braçes

FINANCIM

Qeveria miraton ngritjen e Bankës Shqiptare të Zhvillimit

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, një institucion financiar që do t'i shërbejë nxitjes së zhvillimit ekonomik duke mbështetur me fonde të sektorëve të nën-financiar.

Në një deklaratë për mediet, pas mbledhjes së qeverisë, ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj bëri të ditur se ky institucion është krijuar bazuar në eksperiencat më të mira të institucioneve të ngjashme në BE.

"Ka për synim të financojë zhvillimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale, të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të financojë projekte infrastrukturore dhe gjithashtu të mbështesë eksportet shqiptare", u shpreh Ibrahimaj.

Ndër të tjera, theksoi ministrja, do të japë mundësi shtesë për rritjen e qasjes në financë

të asaj pjese të popullatës e pasërbyer nga sektori bankar, apo ndodhen në zona rurale përmes

tregun italian.

"Gjithashtu, ka për synim që të bashkëpunojë me insti-



produkteve të kursimit që do të mblihdhen dhe përdoren për zhvillimin ekonomik të vendit.

Draftligji është hartuar në bashkëpunim me "Cassa Depositi e Prestiti", institucionin lider në BE për dhënien e financimeve me rezultate konkrete në zhvillimin ekonomik në

tucionet financiare ndërkombëtare të BE-së që kanë në dispozicion fonde të drejtuara drejt vendeve anëtare dhe atyre në proces anëtarësimi në BE, me qëllim rritjen e produktivitetit, konkurrueshmërisë dhe lehtësimin e hyrjes në tregun e BE-së", deklaroi Ibrahimaj.

Fuqizimi i rolit të gruas në ekonominë rurale, BB: Pjesë e vendimmarrjes

Për vite me radhë, bujqësia dhe pylltaria në Shqipëri kanë qenë sektorë që tradicionalisht janë drejtuar nga burrat, por sot situata ka ndryshuar.

Projektet e mbështetura nga Banka Botërore, si Projekti i Shërbimeve Mjedisore dhe Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes, kanë krijuar më shumë hapësira për gratë për të marrë role drejtuese, duke i bërë ato më të pavarura dhe fuqizuara ekonomikisht.

Banka Botërore, përmes një postimi në rrjetet sociale sot renditi arritjet kryesore nga zbatimi i projekteve mbështetëse, ku veçon se: 1058 gra kanë përfutur pagesa nga punët sezonale.

Sipas BB, gratë përbëjnë 50% të bordeve të shoqatave

pyjore dhe gratë u përfshinë në 94% të fazën së përgatitjes së propozimeve, duke u bërë pjesë

nga sistemet e modernizuara të ujitjes dhe drenazimit.

Pjesëmarrja dhe rritja e rolit



e vendimmarrjes për përdorimin e tokës. Ndërsa 106 mijë fermerë (50% gra) përfutuan

drejtues të grave në sektorin e bujqësisë konsiderohet si faktor kyç në fuqizimin e ekonomisë rurale.

Aplikimet për kullotat verore - Në Tepelenë, 20 mijë ha kullota dhe 1 mijë hektarë pyje

(Vijon nga faqja 2)

Në zonën e Tepelenës rreth 100 blegtorë aplikojnë çdo vit për të përfutur nga këto hapësira të dedikuara për kullotë.

Ky proces ndihmon jo vetëm në mbështetjen e fermerëve dhe zhvillimin e blegtorisë, por edhe në menaxhimin e qëndrueshëm të tokave dhe burimeve natyrore.

"Kërkesat i kemi pak a shumë të njëjta si çdo vit. Këtë vit, duke qenë se kemi pasur kontrata me afat më të gjatë deri në 3 vjet, numri i kërkesave i bie të jetë më i ulët, por jo numri i kontratave," thotë z. Shehu.

Me hapjen e aplikimeve,



blegtorët kanë mundësinë të sigurojnë kullota për bagëtitë e tyre, duke lehtësuar kështu punën e tyre dhe garantuar

mirëqenien e tufave.

Ky proces mbetet një faktor kyç për zhvillimin e sektorit blegtoral në Tepelenë.

AmCham: Udhëzimi i ri "Për TVSH", krijon ambient konkurrues dhe të drejtë

Dhoma Amerikane ka përsëritur miratimin e udhëzimit "Për TVSH".

Sipas AmCham-it, udhëzimi bën të mundur harmonizimin e legjislacionit të TVSH-së me atë evropian, si dhe për krijimin e një ambienti konkurrues dhe të drejtë për ofruesit shqiptarë

i barrës së pajustificuar të TVSH-së për shërbimet ndaj klientëve të huaj.

Bëhet fjalë për rastet kur vendi i furnizimit të shërbimit sipas ligjit për TVSH është në një vend të huaj, aty ku është vendosur marrësi i shërbimit. Më parë, Udhëzimi përcak-

më që ai të jetë domosdoshmërisht i regjistruar për TVSH në vendin e tij. Mjafton që ai të jetë një subjekt që kryen veprimtari ekonomike dhe të ketë një numër identifikim biznesi.

Ky ndryshim do të rrisë mundësinë e bizneseve shqiptare për të ofruar shërbime edhe në vendet ku nuk zbatohet TVSH, por taksa të tjera, si tatimi mbi shitjet ose qarkullimin (përfshirë SHBA-në) duke rritur konkurrueshmërinë e bizneseve shqiptare dhe duke ulur kostot për përfituesin e shërbimeve.

Po ashtu përcaktimi i rregullave të reja të trajtimit me TVSH 0% për projektet e financuara në bazë të një marrëveshjeje granti ose të ngjashme.

Udhëzimi i ri përcakton rregulla të reja në lidhje me trajtimin si furnizim i ngjashëm me eksportet, pra me TVSH 0% të furnizimit të mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.



të shërbimeve.

Udhëzimi i miratuar nga Ministria e Financave përbën një ndryshim të rëndësishëm për bizneset që ofrojnë shërbime për klientë jashtë Shqipërisë, në vende ku nuk zbatohet TVSH.

Tashmë bizneset që ofrojnë shërbime në tregun amerikan do të kenë mundësi të tarifojnë me TVSH 0%, duke lehtësuar ndërveprimin e biznesit mes dy vendeve.

Ndër ndryshimet më të rëndësishme është eliminimi

tonte se fatura për ofrimin e këtyre shërbimeve do të jetë pa TVSH vetëm nëse marrësi i shërbimeve është një person i regjistruar për TVSH.

Me ndryshimet e bëra në Udhëzim, ky rregull aplikohet për të gjithë furnizimet kundrejt personave të tatueshëm jashtë Shqipërisë (qofshin të pajisur me numër TVSH, kod fiskal apo numër tjetër të ngjashëm).

Pra, për të provuar që një klient i huaj është "person i tatueshëm", nuk do të kërket

Marrëveshja për pensionet me Italinë, Gonxhja: Asnjë vit pune nuk humbet

Ministri për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin, Blendi Gonxhja e cilësoi si hap historik për mijëra qytetarë,

vendeve.

Pas 15 vitesh negociata, marrëveshja u nënshkrua një ditë më parë nga Senati italian.



miratimin nga Senati italian të marrëveshjes për njohjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore të qytetarëve të të dy

"Kjo marrëveshje garanton të drejtat për pensionet e mijëra punonjësve shqiptarë në Itali dhe italianëve në Shqipëri.

Asnjë vit pune nuk humbet. Siguri dhe perspektivë e re për 550 mijë shqiptarë dhe 4 mijë italianë", tha ministri.

Finalizimi i kësaj marrëveshjeje garanton të drejtat e punonjësve shqiptarë në Itali apo të punonjësve italianë në Shqipëri për pensionet.

Objekt i kësaj marrëveshjeje janë përfitimet nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore që përfshijnë përfitimet për pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sigurimin për përfitimin për sëmundjet dhe barrëlidjen dhe sigurimin e papunësisë.

"Përfitime për pension pleqërie, invaliditeti, familjar, sëmundjet dhe papunësinë", theksoi ministri Gonxhja.

IKMT, aksion për lirimin e hapësirave në Liqenin e Shkodrës

Liqeni i Shkodrës pritet që të kthehet sërish në gjendjen e tij natyrale dhe për këtë ka nisur një aksion për pastrimin e tij.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)

ka ndërmarrë aksionin për heqjen e strukturave dhe instalimeve (pinarë dhe dajlanë) në Liqenin e Shkodrës.

IKMT njofton se ky aksion po zhvillohet në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së

Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkinë Shkodër dhe Policinë e Shtetit.

Aksioni është planifikuar që të vazhdojë deri në pastrimin dhe kthimin e këtij resursi në gjendjen natyrale.

INFORMACIONE

Lanë emigrimin dhe investuan në vendlindje, Rama: Bujtina në Tropojë, vatër mikpritëse e turistëve nga e gjithë bota

Turizmi malor dhe investimet për rigjallërimin e tij vijnë të mbeten prioritet i qeverisë, e cila ka ndërmarrë politika nxitëse për mbështetjen e këtyre investimeve.

Një prej tyre është edhe “Paketa e maleve”, e cila siguron mbështetje për investimet në këto zona, duke synuar inkurajimin e banorëve vendas për të investuar në pronat e tyre.

Kryeministri Edi Rama ndau sot në rrjetet sociale modelin e suksesshëm të një agroturizmi në malet e Tropojës, e ndërtuar nga dy vëllezër të rikthyer nga emigrimi.

Kreshnik Nikoçi së bashku me vëllanë e tij Ermalin vendosën të linin emigrimin dhe të ktheheshin në fshatin e lindjes, në Velisht të Tropojës, ku investuan në kodër një bujtinë që është kthyer në vatrën mikpritëse të qindra turistëve nga e gjithë bota.

Kreshniku tregon se pas 5 vitesh në emigrim, bashkë me

të vëllanë u kthye në vendlindje ku hapi edhe bujtinën.

“Me rritjen e numrit të tur-

“Paketa e maleve” krahas zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë rurale, do të



istëve po fitojmë çdo vit më shumë sesa jashtë vendit”, tha ai.

Kreshniku i bëri thirrje çdo të riu të rikthehet në vendin e tij, aty ku ka zemrën dhe më shumë mundësi.

“Shqipëria ofron mundësi të pafundme për atë që ka vullnet dhe dëshirë për punë”, tha ai.

ketë ndikim në promovimin e produkteve “Made in Albania”, si dhe do të sjellë zgjerim të hartës turistike.

Përmes kësaj nisme parashikohen lehtësi procedurash për pronësinë dhe ndërtimin, sikurse edhe politika fiskale stimuluese.

Kredi të lira për bujqësinë - Drejtoresha e AZHBR: Interes i lartë nga fermerët. Garancia sovrane? Gati në mes të vitit

Qeveria ka prezantuar një instrument të ri bankar me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh për të lehtësuar aksesin në kredi për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Ardita Kuçi, në një intervistë për “Money Report” u shpreh se ka pasur një interes të lartë të fermerëve.

ndonjëherë për këto sektorë me normat e interesit preferenciale. Nga sektori bankar dhe bankat e nivelit të dytë na është shprehur se kjo normë interesi kaq e ulët ka qenë e aplikuar vetëm për kreditë për strehim. BSH ka nënshkruar kontratat me bankat e nivelit të dytë, të cilat kanë filluar të lancojnë produktin e tyre. Disa kanë filluar edhe ta marketojnë atë dhe fermerët janë interesuar.

norma e interesit ulet deri në 2 për qind.

“Instrument i rëndësishëm që i atashohet instrumentit financiar të Bankës së Shqipërisë, pasi nëse fermeri shkon dhe aplikon pranë bankës së nivelit të dytë për një kredi, nëse e bashkon me garancinë sovranë, norma e interesit ulet deri në 2 për qind. Për garancinë sovranë, institucioni që do të shërbejë si para filtrë

GARANCIA SOVRANE PER BUJQESINE

Do të mbulojë 70% principalin e kredive

Përfshin fushat:

- Serat
- Agropërpunimin
- Peshkimin
- Agroturizmi
- Investime ne inovacion

abcnews.al

GARANCI SOVRANE PER FERMERET

KUÇI: FOKUS EDHE FINANCIMET PER AGROTURIZMIN

“Bujqësia, në raport me sektorët e tjerë është më pak e kredituar por dua të them se kjo linjë e re financimi, miratuar nga Banka e Shqipërisë në janar, ka filluar të ketë aplikimet e para në bankat e nivelit të dytë. Pas miratimit të kësaj linje të re financimi prej 250 milionë euro për bizneset e vogla dhe të mesme, është kredia më e madhe e dhënë

Ka një interes të lartë. Kjo nismë ka impakt të konsiderueshëm në fushën e bujqësisë”, u shpreh Kuçi.

Ajo u ndal edhe te garancia sovranë, një skemë që i bashkëngjitet instrumentit financiar të Bankës së Shqipërisë prej 250 milionë eurosh. Sipas saj, nëse fermeri aplikon për këtë instrument të bankës, por edhe për garancinë sovranë, atëherë

i bankës do të jetë AZHBR. “, shtoi Kuçi.

Kuçi shtoi se garancia sovranë do të jetë gati nga mesi i vitit.

“Garancia sovranë do të jetë gati pas mesit të këtij viti. Jemi duke diskutuar edhe me grupet e interesit të gjitha kriteret dhe karakteristikat që do të bëjnë garancinë sovranë.”, u shpreh ajo.

Çifti që u kthye në Petrelë dhe ngritën agroturizmin: Asgjë nuk e zëvendëson ndjesinë e të qenit në shtëpi

Kryeministri Edi Rama ndau historinë e Fatjonit dhe Erjolës të kthyer nga emigrimi në Zvicër të cilët kanë ndërtuar në Petrelë një sipërmarrje të

“Kemi bërë një zgjedhje që për shumëkënd mund të duket jo e zakonshme, por që për ne ishte zgjedhja e jetës. Pasi kaluam vite në Zvicër mes një jete të



re dhe kanë vendosur të rrisin fëmijët në Shqipëri, ku, siç e thonë edhe vetë, asgjë nuk krahasohet me ndjesinë e të jetuarit dhe punuarit në tokën tënde.

sigurt e kuptuam që vendi ynë kishte diçka që askund tjetër nuk mund ta gjenim ndjesinë e të qenit në shtëpi”, tha Fatjoni. “Ndoqem zemrën dhe ven-

dosëm të investonim në Shqipërinë tonë jo vetëm për veter dhe të ardhmen tonë, por edhe për fëmijët tanë”, tha Erjola.

“Sot kemi ngritur agroturizmin “Muza” në Petrelë, një oaz që bashkon natyrën, traditën dhe mikpritjen shqiptare. Çdo ditë bashkë me familjen time punojmë, jo vetëm për të rritur Muzën tonë, por edhe për të frymëzuar të tjerët që duan të investojnë në Shqipëri, sepse për ne ky nuk është thjesht biznes, por një mënyrë për të ruajtur traditën dhe krijuar mundësinë për komunitetin dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të zonës së Petrelës”, tha Fatjoni.

“Asgjë në botë nuk e zëvendëson ndjesinë e të jetuarit dhe të punuarit në tokën tënde, pranë njerëzve të tu ndaj puno dhe jeto aty ku ke zemrën, në Shqipëri”, shprehet Erjola.

Financimi në bujqësi, MBZHR: 250 milionë euro kredi të buta me normë interesi në 2%

Më shumë mundësi financimi për bizneset e vogla dhe të mesme në sektorin bujqësor, me qëllim nxitjen e investimeve dhe rritjen ekonomike.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka nisur konsultimet për programin e ri mbi financimin në bujqësi, ku përmes një instrumenti bankar me një linjë financimi prej 250 milionë euro, do të mbështeten investimet në serra, agropërpunim, peshkim, akuakulturë, agroturizëm, inovacion teknologjik në shërbim të zhvillimit rural.

MBZHR informoi sot në një postim në rrjetet sociale se, zv/ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhimo Kote, drejtoresha e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ardita Kuçi dhe përfaqësues të bankave të nivelit të dytë

ishin në Malësinë e Madhe ku prezantuan në një takim me Shoqatën e Bimëve Medici-

financimi 250 milionë euro dhe me normë interesi 3.5%, e kombinuar me Garancinë



nale Aromatike instrumentet e financimit në bujqësi: Kredia e Butë dhe Garancia Sovrane.

Kredia e Butë me një linjë

Sovrane, e ul normën e interesit në 2% dhe mbulon kolateralin deri në 70%, thekson MBZHR.

Rrugë të reja në Alpet e Shqipërisë - BERZH hap tenderin, përmirësim i aksesueshmërisë dhe infrastrukturës së turizmit të aventurës

Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe infrastrukturës së turizmit të aventurës në Alpet e Shqipërisë”. Ky është investimi që parashikohet të kryhet në veri të vendit, me fokus ndërhyrjet në rrugë në një nga zonat me potencial turistik në vend. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka hapur tenderin për kompanitë e interesuara, teksa afati i dorëzimit të ofertave është data 15 prill.

Ndërhyrjet në këtë aks rrugor janë pjesë e projektit për

Infrastrukturën dhe Turizmin në Shqipëri, që financohet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet asistencës teknike dhe granteve të investimeve në një shumë totale prej 40 milionë euro, si dhe nga kredia sovranë plotësuese 60 mln euro e dhënë nga BERZH për qeverinë shqiptare.

Projekti zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, teksa pak ditë më parë në kuadër të tij u lidh edhe kontrata me vlerë 1.52 mln euro për rehabilitimin e segmentit rrugor nga rrethrotullimi i Sop-it deri në Urën

e Darzezës. Rrugat ndodhet në zonën e Semanit dhe filon në kryqëzimin me Rrugën Kombëtare Fier - Vlorë, rrethi Apollonia, vazhdon përgjatë segmentit rrugor Hoxharë dhe përfundon në Urën e re të Darzezës.

Paralelisht, në kuadër të këtij programi BERZH ka zhvilluar edhe tenderë për përmirësimin e rrjetit elektrik në Alpet e Shqipërisë, duke synuar rritjen e aksesit në energji elektrike në këtë zonë.

INTERVISTA

Banka Shqiptare e Zhvillimit, Ekonomi për ATSH: Mbështetje integritit të SME-ve në tregun e hapur european

Banka Shqiptare e Zhvillimit do të mbështesë përshejtimin e integritit të Shqipërisë në BE përmes zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimit të konkurrueshmërisë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), që përbëjnë 80% të vlerës së shtuar në ekonominë shqiptare.

Kështu u shpreh deputetja e Partisë Socialiste, ish-ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Milva Ekonomi në një intervistë për ATSH-në, ku shpjegoi rolin e krijimit të Bankës së parë Shqiptare të Zhvillimit dhe fokusin e mbështetjes.

“Qeveria shqiptare dhe e gjithë shoqëria është e angazhuar që ne ta shikojmë flakurim e Shqipërisë në 2030 në Bashkimin Evropian. Për këtë objektiv, qeveria po punon për përmbushjen e detyrimeve dhe kriterëve, që kërkon procesi i integritit në disa drejtime dhe procese”, tha Ekonomi.

Ekonomi vuri në dukje se, Shqipëria ka shënuar hapa shumë të rëndësishëm në procesin e integritit në Bashkimin Evropian.

Në këtë kontekst, vijoi ajo, kur kaloi procesi screening, ne kemi gëzim që çdo herë që

hapet një nga kapitujt (6 gjithsej) ta prezantojmë në publik, kapitullin dhe çështjet kryesore që ka çdo kapitull.

“Së fundi është hapur Kapitulli i Tregut, që është dhe kapitulli i tretë, dhe është një nga kapitujt e rëndësishëm që do ta bëjë gati ekonominë shqiptare që të jetë gati konkurruese me ekonominë e BE-së. Nisur nga ky fakt institucionet kanë ngritur nevojën për ngritjen e një banke zhvillimi që do të ketë instrumente financiare brenda saj, me fokus mbështetjen e SME-ve, Sepse për tregun shqiptar, SME-të janë 80% e vlerës së shtuar në ekonomi dhe punësojnë mbi 80% të forcës së punës, por ndërkohë mundësia për t’u kredituar është 4 herë më e vogël se ajo e biznesit të madh”, theksoi Ekonomi për ATSH-në.

Në këto kushte, nënvizoi Ekonomi, për të bërë një ekonomi konkurruese, ku shtyllën e zhvillimit e kanë SME-të, qeveria mendon që fondin për zhvillim ta japë përmes një

banke zhvillimi, që adreson specifikisht mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit dhe rritjen e prodhimit konkurrues Made in Albania



në tregun e hapur.

Në këndvështrimin e ekspertës së ekonomisë, Ekonomi shprehet se Banka për Zhvillim do të rrisë konkurrueshmërinë në sektorin bankar përmes ofrimit të kredive me interesa të ulëta.

“Ne kemi 11 banka të nivelit të dytë, por ajo që ndodh është se Banka për Zhvillim që hyn në lojë me bankat e tjera tregtare, ka 51% të aseteve të veta

duhet të rrisin produktivitetin dhe këtë objektiv ato mund ta arrijnë vetëm përmes implementimit të teknologjive bashkëkohore. Banka e Zhvillimit i vjen në ndihmë të gjithë tregut dhe ekonomisë shqiptare”, tha Ekonomi.

Ekonomi shprehet se, Banka e Shqipërisë me lançimin e programit të ri të financimit 25 miliardë lekë kredi për SME-të dhe bujqësinë, ka sjellë përvojën më të mirë europiane në këtë drejtim dhe bashkë me ekspertizën e institucioneve ndërkombëtare dhe diskutimin me të gjithë aktorët, po paraqitë me këtë program modelin për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Sipas saj, sot është fakt që fondi që vihet në dispozicion të programit të SME-ve mbulon 70% të kolateralit, më shumë se çdo herë tjetër, çka do të thotë se ky program nuk ndihmon vetëm ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por mbi të gjitha edhe bizneset bujqësore.

“Bujqësia shqiptare duhet të arrijë disa objektiva shumë të rëndësishme, sepse ne jemi angazhuar që të arrijmë 1 miliard eksporte në 2030-n dhe kjo arrihet duke mekanizuar bujqësinë, shtuar sipërfaqet me vepra ujitëse dhe kulluese, duke zgjeruar sipërfaqet me serra dhe aplikimin e mjeteve të mbrojtjes nga faktorët klimatikë. Fakti që kishim një fond garancie si eksperiencë edhe nga vitet e kaluara dhe në këndvështrimin si do ta përmirësojnë duke avancuar aksesin në financim edhe për sektorin e bujqësisë, qeveria vuri 70% të kolateralit që mundëson pikërisht kreditimin e bujqësisë”, theksoi ajo.

Ekonomi tha se, së bashku me prodhuesit shqiptarë, mund të rrisim më tej cilësinë e bujqësisë të Shqipërisë dhe mund ta sjellim Shqipërinë një hap më pranë integritit në BE.

Pikërisht, vijoi ajo, ky instrument financimi (programi për SME dhe bujqësinë) do të shërbejë si një orientues apo mentorim se si është konceptuar kjo Bankë Zhvillimi që do të mbështesë përafrimin e prodhimit shqiptar me tregun e hapur.

Miratohet hapja e zyrës së BEI në Shqipëri - Yzeiri: Ofrohen kredi me interesa më të ulëta se institucionet e tjera

Komisioni parlamentar i Ekonomisë ka miratuar marrëveshjen me Bankën Evropiane të Investimeve për hapjen e përfaqësishë së këtij institucioni në Shqipëri.

Banka Evropiane e Investimeve, e cila është në pronësi të 27 qeverive të BE-së, si një nga investitorët dhe kreditorët më të mëdhenj globalisht, siguron fonde të konsiderueshme nga tregjet e kapitalit, të cilat më pas i jep hua me norma të favorshme për projektet që plotësojnë kriteret e saj.

Endrit Yzeiraj,
Zëvendësministër për
Punët e Jashtme:

“Banka Evropiane e Investimeve ndihmon me ngritjen e fondeve nga sektori publik për projekte zhvillimore, si brenda BE-së, ashtu edhe në vendet pranë saj. BEI ka investuar deri më sot 458

milione euro. Shumica e investimeve janë kryer në infrastrukturë dhe energji, por edhe në linjat hekurudhore. BEI është një institucion shumë i rëndësishëm nga i cili Shqipëria mund të përfitojë. Ajo është e interesuar për të hapur zyrën e saj në Tiranë dhe do të ketë të njëjtin status diplomatik si zyra të tjera të delegacionit të Bashkimit Evropian.”

Ardhja e Bankës Evropiane të Investimeve në Shqipëri tregon avancimin e vendit drejt rrugës për t’u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe zhvillimin ekonomik. Në këtë mënyrë, Shqipëria bëhet vendi i dytë në rajon, pas Serbisë, që do të ketë një zyrë të këtij institucioni.

Milva Ekonomi, Deputete e PS:

“Ajo që synohet është që BEI të ketë një zyrë përfaqësi-

mi në Shqipëri. Në fakt, BEI është një institucion i rëndësishëm për shkak të investimeve që ka kryer në Shqipëri në projekte të transportit, ujit apo energjisë. Prezenca e BEI-së nxit ardhjen e investitorëve strategjikë. Ardhja e BEI-së tregon se ky institucion e sheh Shqipërinë si një vend me potencial për zhvillimin e këtyre projekteve dhe është një shenjë e mirë për ekonominë e vendit.”

BEI ka nisur financimin e saj në Shqipëri nëpërmjet kredive që në vitin 1995. Deri tani, vlera e zotuar nga banka për financimin e projekteve nëpërmjet kredive është 457.95 milionë euro, ku pjesën më të madhe e zënë investimet në sektorin e transportit me 56.28%, sektorin e furnizimit me ujë me 23.37%, sektorin e energjisë me 15.29% dhe sektorë të tjerë me 5.07%.

Nesti Bello, emigranti që hapi kantinë vere në Perlat, Rama: Shembull për t’u ndjekur nga shumë shqiptarë

Nesti Bello pas 30 vitesh emigrimi në Itali u kthye në fshatin e lindjes, në Perlat të Durrësit ku hapi “Kantinën

ka kapur tregje të rëndësishme si Italia, Zvicra, SHBA-të”.

“Ky është një shembull për t’u ndjekur nga shumë shqiptarë



Bello” dhe vijoi traditën e babaib në prodhimin e një vere cilësore.

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjete sociale historinë e tij, teksa vuri në dukje se, “prodhimi i verës nga kjo kantinë sot

të tjerë që jetojnë mes dilemës për të qëndruar apo ardhur përfundimisht këtu”, tha Rama.

Ndërsa Nesti tregoi se, babai i tij e nisi prodhimin e verës në mënyrë artizanale si rrjedhojë e një pasioni që kishte. “Por me

vajtjen time në Itali kuptuam që vera ishte diçka krejt tjetër nga ajo që kishim imagjinuar ne”, u shpreh Nesti.

“Pas 30 vite punë në Itali me verën, vendosa të kthehem dhe të punojmë në tokën tonë, në kantinën tonë. Duke parë zhvillimin e turizmit në Shqipëri ne kemi arritur në konkluzionin që kemi bërë gjënë e duhur me prodhimin e verës”, tha ai.

Ai tregoi se, fshati Perlat ka traditë në prodhimin e verës dhe ka pasur mbi 450 ha vreshta dhe natyrisht, vuri në dukje ai, “ne vendosëm të ruajmë këtë traditë për prodhimin e verës cilësore”.

“Deri në 30% të prodhimit ne e eksportojmë në Itali, kemi kontakte me Zvicrën dhe USA. Duke pasur eksperiencën si emigrantë që kemi punuar jashtë shtetit në këtë sektor, është një gjë shumë e bukur ta sjellim këtë eksperiencë në vendin tonë të bukur”, tha Nesti.

“Rritet aksesin në financë i pensionistëve” - Ministria Ibrahimaj: Tekstilet, një tjetër sektor që do të mbështetet nga Banka e Zhvillimit

himaj, theksoi se përveç mbështetjes së sektorit privat me kredi, një tjetër përfitim nga Banka e Zhvillimit është rritja e aksesit në financë të pensionistëve dhe studentëve nga depozitat përmes Postës Shqiptare.

“Synojmë që të aksesojmë ato target grupe të cilat nuk janë të mbuluara nga sektori bankar me depozita dhe kemi

vënë si shembull pensionistët, por nuk kufizohet te pensionistët. Pra, do të jenë produkte të cilat do të shkojnë për të mbledhur kursimet e atyre target grupeve që nuk kanë kursime, nuk kanë depozita. Një rast janë pensionistët, mund të jenë studentët, mund të jenë qytetarë në zona remote, ku nuk degë të bankave dhe akses në financë. Për sa

i përket individëve, është e rëndësishme të theksojmë që Banka në drejtim të financimit dhe mbështetjes, synon të financojë privatën dhe jo individët. Nuk limitohet të bujqësia, mund të jenë dhe sektorë të tjerë, ne kemi pasur rastin e prodhuesve të tekstileve”.

Gjatë fjalës së saj, Ibrahimaj u ndal gjithashtu në kriteret që duhet të plotësojnë bizneset

në bujqësi për të përfituar kredi me norma të ulëta interesi.

“Patjetër që ky entitet nuk do të financojë subjekte të pafinancueshëm, pra fillimisht subjektet duhet të jenë të formalizuara, duhet të kenë një historik të punës që kanë kryer, por nga ana tjetër, pra, nëse subjekti është i pafinancueshëm, edhe kjo Bankë nuk mundet ta financojë. Por ndërkohë, nëse ka

një potencial, një plan biznesi që është i qartë dhe është i financueshëm, patjetër që ai do të ketë nëpërmjet strukturave të këtij institucioni, nëpërmjet instrumenteve që do të nxjerrë, do të ketë mundësi që të marrë kredi me kosto më të ulët dhe pasur nevojë të vendosë atë kolateral për të cilën ka nevojë një kredi normale”.

Eksperienca në vendet e tjera ka treguar se Banka e Zhvillimit do të ndihmojë edhe në përthithjen dhe shpërndarjen efektive të fondeve të Bashkimit Evropian.

ANALIZË

Fatos Çoçoli: Pse shtohen eksportet bujqësore?

Janari 2025 solli shitje produktesh bujqësore jashtë vendit 34 për qind më shumë dhe me vlerë 14.5 për qind më të madhe. Nuk kishte ndodhur në njëzet vitet e fundit. 52 milionë euro subvencion shtetëror vitin e kaluar. U mbështet fort nafta në bujqësi

Eksportet bujqësore shënu-

së standardeve më të larta. Sipas INSTAT, krahasuar me vitin 2023, eksportet bujqësore u shtuan në sasi me 21 për qind.

Shtimi në sasi i produkteve bujqësore tregon realisht rritjen, pasi vlera mund të të gënjejë, për shkak të rritjes së çmimeve të këtyre produkteve. Gjatë vitit 2024, Shqipëria eksporto i mbi 471 mijë tonë produkte bujqësore, kundrejt 390 mijë tonëve produkteve që u eksportuan në vitin 2023.

Faktorët e shtimit

Rritja e eksporteve të produkteve bujqësore “Made

produkteve shqiptare. Ata po e rrisin praninë e tyre në mënyrë të qëndrueshme në tregjet ndërkombëtare.

Përmes një akti normativ, në fund të dhjetorit të vitit 2024, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural mori nga qeveria 1.4 miliardë lekë shtesë, ose 14 milionë euro. Ky fond u përdor për të mbuluar të gjitha kërkesat e fermerëve aplikantë në Skemën Kombëtare të Zhvillimit të Bujqësisë 2024, të cilët plotësojnë kriteret e përfitimit për tetë masat mbështetëse për vitin 2024.

Rritja e prodhimit dhe eksporteve bujqësore është nxitur nga investimet në sera, në pikat e grumbullimit, në magazinat frigoriferike dhe në gjithë zinxhirin tregtar. Ndikim në këtë zgjerim, ka dhënë edhe skema e subvencionit të naftës dhe fakti që tani fermerët e marrin naftën drejtpërsëdrejti. Zonat me bujqësi më intensive në vend janë Berati, Lushnja, Fieri e Divjaka, ku sigurojmë mbjellje me dy sezona.

Me vendimin e fundit të qeverisë, mbështetja për bujqësinë dhe blegtorinë arriti një total prej 5.2 miliardë lekë, ose 52 milionë euro.

Sa ndihmoi Skema Kombëtare e Bujqësisë 2024?

Skema Kombëtare për vitin 2024 mbështeti me dhjetëra mijëra fermerë, përmes tetë masave të saj, ku mbi 52 mijë fermerë përfituan mbështetje për naftë.

Tabela 3. Tetë masat e Skemës Kombëtare të Bujqësisë 2024

- Mbështetje tufa bazë e matrikulluar (gjedhë dhe të imta)
- Mbështetje për bletarinë
- Mbështetje për fermat organike
- Mbështetje për çertifikimin Global Gap
- Mbështetje për fara, fidanë dhe inpute të tjera
- Mbështetje për bimët mjekësore-aromatike
- Mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

Skema Kombëtare 2024 ofroi mbështetje për 8 masa: tufën bazë të matrikulluar (gjedhë dhe të imta), bletarinë, fermat organike, çertifikimi Global Gap, fara, fidanë dhe inpute

Tabela 2. Faktorët që sollën rritjen e eksporteve bujqësore, fillim viti 2025:

- Investimet në sera
- Investimet në pikat e grumbullimit
- Shtimi i magazinave frigoriferike
- Zgjerimi i subvencionit të naftës
- 14 milionë euro fond shtesë në dhjetor 2024

Këtë vit bujqësia nisi me këmbë të mbarë. Sipas INSTAT, eksportet bujqësore u rritën me 34 për qind në vlerë dhe me 14.5 për qind në sasi në janar 2025, në krahasim me janarin 2024.

Rritje në tregues të tillë vetëm për muajin e parë të vitit nuk kemi njohur në këto dy dekadat e fundit.

Çfarë eksportojmë?

Në produktet bujqësore të eksportuara, kryeson domatja nga grupi i perimeve të serrave, ku Shqipëria është e favorizuar nga prodhimi më i hershëm, për shkak të klimës.

Ndër produktet kryesore të eksportuara janë gjithashtu: kastravec, speci, lakra, qepa, preshi, dhe drufrutorët ku kryeson molla etj., për të vijuar me bimët mjekësore dhe prodhimet e agropërpunimit, si peshk i konservuar, etj., ndërsa gjeografia e eksporteve “Made in Albania” është shtrirë në mbi 80 shtete të botës.

Tabela 1. Eksportet bujqësore me vlerë më të lartë, 2024:

- Domate	32%
- Kastravec, speci, lakra, qepa dhe preshi	11.2%
- Molla, mandarinat, luleshtrydhe, shalqinj, rrush, etj.	19.6%
- Bimët mjekësore dhe aromatike	9.4%
- Vaji i ullirit	6.7%
- Peshk i konservuar	6.2%

Totali 2024: 550 mln euro

an rritje të ndjeshme gjatë vitit të kaluar dhe inercia u ndje dhe në këto dy muajt e parë të këtij viti.

Fermerët tanë ia dolën të përmirësojnë në mënyrë cilësore produktet me të cilat konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare, përmes kapjes

in Albania” jep një pasqyrë të qartë të shtimit të cilësisë dhe fuqizimit të fermerëve në vend. Politikat mbështetëse të qeverisë dhe Skema Kombëtare e Bujqësisë 2024 bënë që fermerët të shtojnë investimet në përmirësimin e cilësisë dhe të standardeve të

Projekti i Shërbimeve Mjedisore asistencë teknike, 229 komuniteteve malore rurale

ruesve të Pyjeve dhe Kullotave Shkodër

“Për shkak të shkëmbimit të njohurive përmes trajnimeve të

Korçë

Sfida

Një dekadë më parë, py-



kryera nga ekspertët suedezë, ne jemi në gjendje të mblehim dhe analizojmë të dhënat për Inventarin, pa asistencë të jashtme nga partnerët tanë të zhvillimit, që do të thotë se ekspertët shqiptarë mund ta kryejnë këtë detyrë vetë. - Ekspert, Universiteti Bujqësor i Tiranës

“Ne kemi shprehur qëndrimet tona gjatë hartimit të Planeve të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Korçë dhe janë marrë në konsideratë pothuajse të gjitha. - Anëtar i Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia

jet dhe kullotat e malësive të Shqipërisë po humbin tokën me një shkallë maramendëse prej 20 deri në 90 tonë për hektar çdo vit – humbje të shkaktuara kryesisht nga praktikatat e dobëta të menaxhimit të tokës. Kjo tokë mbuloi rrugët ujore dhe rezervuarët e vendit. Ai gjithashtu minoi rendimentet bujqësore dhe pyjore në zonat më të varfëra të Shqipërisë, pikërisht në zonat ku jetesa e shumicës së njerëzve varet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga pyjet dhe kullotat.

Këto sfida në terren u ndërlikuan nga pronësia e paqartë e tokës pyjore, mungesa e informacionit të saktë rreth përdorimit të tokës dhe paqartësia rreth menaxhimit, politikëbërjes dhe roleve të kontrollit. Kjo pasiguri administrative buronte pjesërisht nga shtytja e fundit e Shqipërisë për t'i transferuar tokat pyjore shtetërore te pushtetet vendore, të cilave u mungonin fondet për menaxhimin e qëndrueshmërisë së tyre. Në nivel kombëtar, nga viti 2007 deri në vitin 2012, vetëm 5% e shpenzimeve publike mjedisore i janë kushtuar pylltarisë.

Qasje

Projekti i Shërbimeve Mjedisore përdori grante konkurruese si mjetin kryesor për të arritur një menaxhim më të qëndrueshëm të tokës në Shqipëri. Ai dha një total prej 8.34 milionë dollarësh në 153 grante - kryesisht për shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave - për të rimbjellur pyje, për të ndërtuar diga kontrolluese, për të shkurtuar dhe rralluar pyje për të përmirësuar shëndetin e tyre dhe për të zbatuar afro 250 praktika të tjera të menaxhimit të qëndrueshëm të

tokës.

Kriteret për shumicën e këtyre granteve u përafrian me Instrumentin e BE-së për Asistencën e Para-Aderimit për Zhvillimin Rural (IPARD), i cili fokusohet në qëndrueshmërinë dhe përafrimin e politikave të BE-së në zonat rurale të vendeve në proces të anëtarësimit në BE. Duke përdorur këto kritere, projekti ndërtoi kapacitete, mbështetje dhe njohuri thelbësore që e pozicionojnë mirë Shqipërinë për të marrë financime në të ardhmen nën këtë mekanizëm.

Projekti i Shërbimeve Mjedisore ndoqi gjithashtu një menaxhim më të qëndrueshëm të tokës në Shqipëri duke ndërtuar një mjedis të qëndrueshëm institucional për të menaxhuar zonat malore dhe për të trajtuar erozionin dhe degradimin e tokës. Ai ndihmoi vendin në Sistemin Informativ të Pyjeve të Shqipërisë, planifikimin e pyjeve, zotërimin e tokës dhe fuqizimin e përfituesve vendas.

Rezultatet

Si rezultat i Projektit të Shërbimeve Mjedisore (2014-2021), shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe subjektet e tjera

të tjera, bimët mjekësore-aromatike, si edhe mbështetja me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

Për të tretin vit radhazi, Shqipëria plotësoi me 100 për qind pagesat për fermerët e kualifikuar të Skemës Kombëtare direkte në bujqësi 2024. Pra, i gjithë fondi prej 52 milionë eurosh, iu shpërnda fermerëve.

Në vitin 2024, vlera e përgjithshme e eksporteve bujqësore arriti në 550 milionë euro, ndërsa ambicia e qeverisë është që brenda dekadës ta çojë në një miliardë euro.

Ndërkohë, financimi përmes Kredisë së Butë dhe Garancisë Sovrane në linjën 250 milionë euro të hapur nga Banka e Shqipërisë, do të ndihmojë bizneset e vogla dhe të mesme në sek-

torin bujqësor, që të investojnë me kushte lehtësuese.

Kredia e Butë me një linjë financimi 250 milionë euro dhe me normë interesi 3.5%, e kombinuar me Garancinë Sovrane, e ul normën e interesit në 2% për bizneset në 5 sektorë kyç të ekonomisë. Dhe sektori kryesor është pikërisht bujqësia. Eksportet bujqësore shqiptare ende kanë shumë për të thënë.

tani menaxhojnë 12,320 hektarë zona malore në Shqipëri duke përdorur të qëndrueshme. Kjo përfshin:

5580 hektarë përfitojnë nga praktikatat silvikulturore

3325 hektarë përfitojnë pika ujore për blegtorinë më të mirë


1,133 hektarë të stabilizuar me erozion të reduktuar të tokës nga ndërtimi i digës së kontrolluar

Përmirësimet e përgjithshme në shërbimet e ekosistemit nga këto praktika japin një bilanc karboni prej -811,262 ton ekuivalent të dioksidit të karbonit (tCO2-e) gjatë 20 viteve.

Projekti gjithashtu arriti rezultate thelbësore në fushat kryesore të qeverisjes, administrative dhe kapaciteteve të planifikimit:

Asistenca teknike e projektit e ndihmoi vendin të plotësonte Inventarin Kombëtar të Pyjeve të Shqipërisë dhe Sistemin Shqiptar të Informacionit Pyjor. Për herë të parë Shqipëria ka krijuar një sistem kombëtar informacioni pyjor, i cili mbështet menaxhimin e të dhënave pyjore dhe unifikimin e të dhënave të kadastrës pyjore.

U përgatitën plane për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave për 191,066 hektarë, me udhëzime për përdorim të qëndrueshëm dhe procese pjesëmarrëse.



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



Dilemat në kultivimin e misrit për vitin 2025

Prof. as. Kostandin Hajkola, QTTB Shkodër

Për vitin 2024, sipërfaqja e mbjellë me bimën e misrit në Shqipëri ishte rreth 60 000 ha. Kushtet e mira të filimpranverës favorizuan mbjellje të hershme. Megjithatë një pjesë e ngastrave të misrit arritën fazën e lulëzimit dhe mbushjes së kokrrës në periudhë thatësire dhe temperatura shumë të larta (10-ditori i fundit të muajit Korrik dhe gjatë gjithë muajit Gusht) duke ndikuar negativisht në mbushjen e kallirit, peshën e kokrrës që u shprehen në rendimente të ulëta të prodhimit të misrit. Prodhimi ishte rreth 350 000 ton, 5.8 ton/ha (ose rreth 15 % më pak se në vitin 2023). Edhe në vendet e rajonit (Serbi, Rumania, Bullgari, Hungari) rënia e prodhimit ka qenë në nivelet 30-40 % kundrejt vitit 2023.

Faktorët dominues në rënien e prodhimit për vitin 2024

- Kushtet klimatike: mungesë e reshjeve në periudhën e vegetacionit, thatësi i zgjatur e shoqëruar me temperatura të larta që kanë variuar 2-4 gradë më të larta se shumëvjeçarët në periudhën e lulëzimit. Kjo ka sjellë si pasojë dështime të pllenit, mos mbushje të kallirit dhe peshë më të ulët të kokrrës.
- Rënie e interesit në investime (Inpute, plehërim pesticide, shërbime) sidomos tek kultivuesit me sipërfaqe të vogla. Kjo pasi kultivimi në ngastra të vogla, pa mundësi mekanizimi, shpesh edhe me mungesë ujitje shoqërohet me kosto e lartë prodhimi, ndër-kohë që çmimi në treg vazhdon të jetë i ulët.

Dukuri pozitive

- Zgjerim i sipërfaqeve të mbjella me misër, numër më i madh i fermerëve me sipërfaqe kultivimi 30-150 Ha. Në rreth 20 000 ha, aplikohen teknologji të nivelit për të marrë 10-14 ton/ha. Në disa zona si Vurgu, Sheqeras, Levan, Nënshkodër etj megjithëse patëm thatësi të stërzgjatur shoqëruar me temperatura të larta në lulëzim, rendimenti pati rënie jo më shumë se 10-12 % në krahasim me vitin e kaluar. Në ngastrat e fermerëve të vegjël rënia e prodhimit ishte më e madhe.
- Subvencioni në karburante ka dhënë efekt në uljen e

kostos së prodhimit të misrit tek fermerët e mëdhenj që kanë mundësi mekanizimi të plotë.

- Gjatë vitit 2024, pati rënie të çmimeve të disa inputeve (kryesisht plehrave azotike) në krahasim me vitin e kaluar, gjë që solli shërbime dhe ushqyerja të bimës në kohë dhe në sasi optimale.

- Fuqizimi i fermave të mëdha blegtorale të gjedhit në zonën fushore, është shoqëruar me mbjelljen e rreth 5000 ha me misër për silazh me kall. Kjo është e lidhur me domoshmërinë e përdorimit të silazhit të misrit në të ushqyerit gjithëvjetor në veçanti të gjedhit, në kushtet e një mbarësh-timi intensiv.

Për vitin 2024 tregu i farës së misrit ofroi hibride mjaft cilësore, me kapacitet prodhues të lartë dhe të përshtatshëm për kushtet e fermerëve tanë.

Edhe këtë vit tregu i farave do të jetë i plotë me fara hibride që kanë shfaqur performancë të mirë edhe në kushtet e ndryshimeve të ndjeshme klimatike. Vlerësimi për performancën e tyre realizohet falë provave të demonstrimit dhe testimit që realizon QTTB Shkodër në disa pika ekologjike të Shqipërisë si dhe bashkëpunimit me fermerët e mëdhenj e të mesëm në aplikimin e teknologjive të përparuara. Përveç kësaj, ditët fushore të organizuara nga QTTB Shkodër në disa zona të Shqipërisë u kanë ofruar fermerëve dhe importuesve të farave mundësi vlerësimi të performancës së farave të reja hibride dhe zgjedhje më të mira për vitin 2025.

Çfarë pritet në prodhimin e drithërave për vitin 2025

Në vendin tonë konstatohet mbjellje e një sipërfaqe më të vogël me bimën e grurit në vjeshtën e vitit 2024. Arsyt kryesore janë çmimi i ulët në treg dhe realizim i të ardhurave të pakta për njësi të sipërfaqes. Ky fenomen është i dukshëm në zonat me traditë në kultivimin e grurit në qarqet Korçë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër etj. Vlerësohet mbjellja e 10-12 000 ha më pak se vjeshta e vitit

2023.

Në rajon dhe më gjerë sipas FAO-s, tregtia ndërkombëtare e grurit parashikohet të ulet për periudhën 2024/25 deri 5.6 % krahasuar me një vit më parë. Faktor kryesor vlerësohet mbajtja e një niveli më të ulët të rezervave si dhe ulje e kërkesës nga konsumatorët e mëdhenj për këtë produkt (Republika e Kinës). Në vendet e rajonit sipërfaqja dhe prodhimi i grurit pritet të jetë 5-6 % më i ulët, kurse çmimet parashikohen të jenë stabël, me luhatje fare të vogla.

Përsa i takon bimës së misrit, në rajon dhe në vendin tonë parashikohet mbjellja e një sipërfaqeje të përafërt me vitin e kaluar, në mos diçka më shumë. Tregu i misrit është stabël dhe nuk parashikohen diferenca të qenësishme deri në fund të vitit 2025. Një ndryshim i vogël në rritje pritet të këtë për çmimin e farave hibride që do të tregtohen në këtë sezon mbjelljesh. Po kështu një rritje 10-15 % parashikohet edhe për plehrat azotike.

Karakteristikat e hibrideve të misrit dhe zgjedhja e tyre

Për shkak të ndryshimeve klimatike, thatësirave gjithnjë e më të stërzgjatura pikërisht në periudhën kur misri kalon fazat kritike të zhvillimit (lulëzim - mbushje kalliri), vëmendje duhet t'i kushtojmë zgjedhjes së hibridit më të përshtatshëm për kushtet konkrete të kultivimit. Tashmë qendrat kërkimore dhe kompanitë e prodhimit të farave po i paraprijnë me krijimin e hibrideve gjithnjë e më tolerant ndaj këtyre ndryshimeve duke garantuar qëndrueshmëri në rendiment dhe prodhim më cilësor. Disa nga këto karakteristika të hibrideve të reja i gjejmë të reklamuar në ambalazhet me certifikatat përkatëse. Të tillë janë shumica e hibrideve të misrit të krijuar nga kompanitë KWS, Pionner, Dekalb, Limagrain etj. Tregues të tillë si PLUS4GRAIN, i dedikohen hibrideve që kanë këto karakteristika:

- Efektivitet i lartë në shfrytëzimin e burimeve

agroekologjike gjatë kultivimit intensiv

- Më shumë kokrra për bimë
- Peshë më e madhe e 1000 kokrrave

- Efiçencë më e lartë e shfrytëzimit të ujit dhe lëndëve ushqyese në dispozicion.

Karakteristika të tjera domethënëse janë emërtesat për tipin e hibridit. Hibridet me kallë fiks janë produkt i një gjeneratë të re të seleksionimit të misrit, ku kalliri është me madhësi të qëndrueshme në një variacion të gjerë të dendësisë së bimëve, nga 55,000 deri 85,000 bimë/ha. Synimi këtu është të ruhet madhësia e qëndrueshme e kallirit dhe të rritet rendimenti përmes dendësisë më të madhe, shoqëruar me investime më të mëdha në plehërim, ujitje etj.

Hibridet me kallë Flex funksionojnë ndryshe. Këta hibride kanë aftësinë për të krijuar kallë më të mëdhenj në dendësi më të vogla. Ata japin rendimente më të larta kur mbillen në 55,000 deri në 65,000 bimë/ha.

Në vitet e fundit shumica e kompanive, krijuese dhe prodhuese të farave hibride të misrit synojnë hibridet e tipit Climate-control 3. Këto hibride kanë përparësi pasi janë tolerante ndaj thatësirës dhe temperaturave të larta. Karakteristikat bazë të këtyre hibrideve janë:

- Deri në fazën e lulëzimit: Hibridet kanë fuqi rritëse të madhe, duke ulur efektet negative të stresit nga temperaturat e ulëta (nënkupton mbjellje të hershme), duke intensifikuar dhe siguruar rritjen dhe zhvillimin e elementeve prodhues (numër optimal reshta, numër optimal kokrra ne resht).
- Në fazën e lulëzimit: Dalje e plotë e organeve të riprodhimit (xhufka dhe mustaqet), me diferenca të vogla në kohë duke siguruar pjallim të sigurt dhe pllenim i plotë i të gjitha vezoreve.

- Pas lulëzimit: zënie dhe mbushje e stabilizuar e kokrrës, shoqëruar me tiparin “stay green” të bimës, tipar me ndikim pozitiv në rrjedhshmërinë normale të mbushjes së kokrrës edhe në kushtet e stresit të thatësirës.

Në mbështetje të karakteristikës së parë, një aftësi rritëse të shpejtë në fazat e para, pra një “shkurtim” të fazës mbirje lulëzim, shumica e kompanive të prodhimit dhe tregtimit të farave hibride të misrit po përdorin tekniken e trajtimit të farave përveç pesticideve edhe me biohormone. “Simulantët” e rritjes me prejardhje natyrore ofrojnë një mundësi të mirë drejt përdorimit të praktikave që ofrojnë përfitime financiare dhe mjedisore (efikasitet më i lartë në përdorimin e treguesve agroekologjikë si dhe koeficient më të lartë në shfrytëzimin e plehrave kimike). Aktualisht trajtimet me biostimulante të farave përdoren në më shumë se 10 milionë hektarë në Evropë, kryesisht me bimët e arave. Ndër emërtesat tregtare kryesore janë Lumidapt, Lumibio Kelta, Lumibio Optima etj.

Duhen njohur dhe respektuar kushtet agroekologjike të zonës, të zgjedhim ato hibride që sjellin rendimentet më të mira në ato kushte. Para së gjithash, duhet t'i kushtojmë vëmendje grupit të pjekjes. Nëse sipërfaqja që kultivojmë me bimën e misrit është mbi 10 ha, është mirë të përdoren 2-3 hibride nga grupe të ndryshme të pjekjes. Në këtë mënyrë reduktohet rreziku dhe rritet efektshmëria. Kur zgjedhim vetëm hibride të vonë, për shkak të kushteve të pafavorshme të motit ndodh që ato të lulëzojnë në temperatura të larta shoqëruar me thatësi. Kjo sjell kallë të dobët dhe pjekje të vonë, pasuar me lagështirë të lartë në kokërr. Kjo e fundit rrit koston e tharjes dhe është shkak për shfaqjen e sëmundjeve të kallirit, infeksion nga mykotoksinat, dëmtimin e prodhimit. Gjeneratat e reja të hibrideve të mesëm apo ½ të hershëm, i afrohen shumë hibrideve me pjekje të vonshme për nga kapaciteti prodhues, por kanë një efektivitet më lartë ekonomik (më pak shpenzime për ujitje dhe tharje), janë më pak të ndikuar nga streset e temperaturave të larta dhe thatësira në fazat delikate të lulëzimit dhe mbushjes së kokrrës. Duhet të zgjedhim dhe t'i kushtojmë vëmendje shpejtë-

sisë se lëshimit të lagështirës në fazën e pjekjes.

Hibridet e misrit për silazh

Për ushqim të blegtorisë, misri mund të kultivohet edhe me qëllim të përdorimit të tërë bimës së tij, në formën e silazhit ose produkteve të caktuara të dehidratuara (s.p.sh. mielli nga e gjithë bima e misrit, briketa, etj). Cilat janë specifikat e kultivimit të misrit për silazh?

Përgatitja dhe përdorimi i silazhit është i zakonshëm në kushtet e fermave që mbarësh-tojnë kafshë, në veçanti komplekset e gjedhit për qumësht apo mish. Ka një qasje më të mirë në vitet e fundit drejt rritjes së sipërfaqeve të misrit për silazh. Nga një hektar i kultivuar për silazh mund të prodhohen 300-500 kilogramë “mish” më shumë sesa kur përdoret si drithë (koncentrat kokërr). Silazh mund të bëhet edhe nga bimë të tjera, sorgumi, tritikalet ose elbi. Edhe në këto raste përgatitet silazh i cilësisë së mirë. Megjithatë, më i preferuari është silazhi i misrit. Arsyeja kryesore është se një hektar misër për silazh jep më shumë lëndë ushqyese totale për ha se çdo bimë tjetër. Rendimenti i misrit për silazh shprehet përmes sasisë së njësive ushqyese për ha, dhe jo në formën e kilogramëve, metra kub apo tonelatat e masës së gjelbër.

Misri për silazh kultivohet pak a shumë në të njëjtën mënyrë si misri për kokërr. Ndryshimet kryesisht i referohen zgjedhjes së hibrideve, mbjelljen e një numri më të madh bimësh për njësi sipërfaqe, doza plehërimi më të mëdha dhe sigurisht afatit të vjeljes. Sa i përket zgjedhjes, ka hibride që janë të përshtatshëm specifikisht për marrjen e masës sa më të madhe për silazh cilësor. Një hibrid i karakterizuar nga rendimenti i lartë për kokërr mund të jetë i mirë edhe për silazhim sepse kokrra në fakt përmban pjesën më të madhe të totalit të njësive ushqyese. Por jo gjithmonë është kështu. Tipet e hibrideve “stay green”, me kapacitet të lartë në prodhimin kokërr janë më të mirë në përdorimin e tyre për silazh. Misri për silazh korret në fazën e pjekjes së plotë të dyllit.

Institucionet që menaxhojnë fondet e BE-së në Shqipëri do t'i nënshtrohen kontrolleve më të rrepta për shmangien e abuzimeve të mundshme. Është hedhur për konsultim publik “Strategjia Kombëtare kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian”, ndër synimet e të cilës janë zbulimi i mashtrimeve të zyrtarëve publikë me fondet e Bashkimit Evropian, si dhe përmirësimi i kontrolleve të brendshme, në funksion të parandalimit të këtyre parregullsive. Nëpërmjet kësaj strategjie sigurohet administrimi dhe përdorimi i

Abuzimi me fondet e BE, shtohen kontrollet - Nga ARACHNE, te hetimet dhe ndjekja penale. Cilat janë masat e strategjisë së re?

fondeve të BE-së në mënyrë të efektshme gjatë periudhës së saj të para – anëtarësimit.

Fondet e Bashkimit Evropian në Shqipëri mund të ekspozohen ndaj risqeve që përfshijnë pagesa për kontraktin që ka shkelur kontratën, përzgjedhje e parregullt e aplikimit të projektit, dhënie e kontratës aplikantit, i cili nuk do të përzgjidhej, nëse do të zbatoheshin procedurat konkurruese, pagesë për

një përfitues për shpenzime të papërshtatshme, përzgjedhje e një aplikimi të rremë të projektit dhe të tjera.

Me qëllim shmangien e keqpërdorimit të ndihmave financiare të BE-së në të ardhmen, masat e reja që do të ndërmerren kanë të bëjnë me krijimin e një kuadri ligjor të përshtatshëm për sigurimin e një mjedisi të mbrojtur nga mashtrimi, promovimin e parandalimit të mash-

trimit midis nëpunësve dhe zyrtarëve publikë, përmes rritjes së ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe publikut për parandalimin e parregullsive dhe rasteve të dyshimta të mashtrimit, por gjithashtu edhe nëpërmjet përditësimit të planeve të integritetit të institucioneve përkatëse.

Një objektivi tjetër lidhet me maksimizimin e efektshmërisë së kontrolleve për parandal-

imin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit. Në kuadër të këtij objektiivi do të vendoset në funksion ARACHNE, një instrument i avancuar i teknologjisë së informacionit, i krijuar për të ndihmuar autoritetet menaxhuese të identifikojnë projekte me rrezik të lartë, duke analizuar grupe të mëdha të dhënash që lidhen me projektet e financuara nga BE-ja.

Institucionet përkatëse do

të angazhohen më shumë për hetime dhe ndjekje penale, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Nga kjo parashikohet edhe sh-timi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, por edhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik (AFCOS) me Zyrën Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF), në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe hetimeve.

Hartimi i kësaj strategjie është detyrim që rrjedh nga procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

PORTRET

Kristaq Kola - Agronom me diplomë të artë, por me “cen” në biografi

Nga: Agr. Koço Mosko, Boston, SHBA

Agronomi Kristaq Kola lindi në qytetin e Gjirokastrës në 20 tetor të vitit 1933, në një familje tregtarësh artizanë. Babai i tij, Thomai, kishte në ‘Qafën e Pazarit’ një dyqan me emrin “Arbërore”, ku përgatiste e tregonte veshje shajaku të traditës si: kostume popullore, sharqe, guna, etj. Origjina e familjes “Kola” si shumë familje të tjera ortodokse të Lagjes “Varosh” është nga fshati i martirizuar i Hormovës, që ndodhet në skajin verior të faqes lindore të malit të Lunxhërisë. U detyruan të shpëngulen nga fundi i viteve 1700, pas masakrës së tmerëshme që bëri Ali Pashë Tepelena në këtë fshat.



Kristaq Kola
(1933 - 2008)

Gruaja e Thomait, nëna e Kristaqit, Aspasia, ridhte nga fisi Mosko nga lagja Pazar i Vjetër, ndën kala. Edhe kjo ishte një familje tregtarësh terzinj. Thomai me Aspinë lindën katër fëmijë, dy djem e dy vajza. Kristaqi ishte fëmija i fundit, më i vogli ndër ta. Ai në fëmijërinë e tij u end në kalldrëmet e rrënuara të rrugëve të lagjeve “Varosh”, “Palorto” e “Hazmurat”. Pati një fëmijëri të trazuar, plot me frikë e pasiguri. Ishte kohë luftrash. Qytetin e gurtë në një kohë shumë të shkurtër e shkelën tri ushtri të huaja: ajo italiane, greke e gjermane.



Prindërit e Kristaqit
Thomai dhe Aspasi Kola

Dyqani “Arbërore” në
Qafë të Pazarit

Shkollimi

Ishin vitet 1939-1944 kur Kristaqi duhej të shkonte në shkollë. Arsimimin fillorë dhe atë shtatëvjeçarë e mori në shkollën “Koto Hoxhi” që ndodhej në lagjen e tij “Varosh”. Që në fillorë ai u dallua për shkathtësi e zgjuarsi. Para së gjithash ra në sy talenti dhe aftësia e tij improvizuese si aktor. Këtë e vunë re mësuesit e talentuar: Koço Kostaqi, Ferhat Kërrri e Urani Zhupa, të

cilët ishin edhe organizatorët e aktiviteteve artistike të shkollës.

Për herë të parë që në vitin 1945, kur ishte në klasën e katërt të shkollës fillore, u aktivizua me sukses në shumë aktivitete të artistike të shkollës. Këtë dhunti të tij ai do ta ushtronte gjatë gjithë jetës, në vitet e shkollës shtatëvjeçare, gjatë gjimnazit si dhe kur mbaroi shkollën e lartë e punonte agronom.

Në vitin 1949 filloi studimet në gjimnazin “Äsim Zeneli”. Edhe këtu u shqua për rezultate të mira në mësim si dhe veprimtaritë artistike, megjithëse stafi drejtues i këtij gjimnazi nuk tregohej shumë dashamirës ndaj tij. Nga vitet e gjimnazit, që ai i quante të bukura, ruante si kujtim disa fotografi me miqtë e tij si: Ismail Kadarenë, Agim Shehun, Bekim Harxhin, etj. Në një nga këto fotografi dallohet edhe “Mësuesi i Popullit” Thoma Papapano.



Një kujtim me “Mësuesin e Popullit” Thoma Papapano dhe ish shokët e gjimnazit, Ismail Kadare, Agim Shehu, Bekim Harxhi, etj.

Në përfundim të maturës, ëndërra e Kristaqit ishte ndjekja e një shkolle arti. Por, në fakt drejtimi që morri në jetë ishte krejt tjetër. Ai u dërgua për studime në Institutin e Lartë Bujqësor, Kamzë, sot Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Në fillimin të studimeve të larta, familja Kola goditet nga një ngjarje e rëndë. Në 8 shtator të vitit 1953, babai i tij, Thoma Kola, dënohet me dhjetë vjet burg me akuzën për “Agjitacion e Propagandë”. Gjendja ekonomike e familjes u rëndua së tepërmi, pasi të ardhurat bazë për familjen siguroheshin nga puna e babait në rrobaqepsinë e dyqanit “Arbërore”. Arsimimi i Kristaqit u rrezikua ndjeshëm, por duket se ndërhyrja e familjarëve dhe kushërinjve të tij, bënë që pavarësisht kushteve të këqia ekonomike, ai ta fillojë vitin e parë në Institutin e Lartë Bujqësor të Kamzës. Një dokument i asaj kohe vërteton më së miri gjendjen e vështirë ekonomike të kësaj familjeje.

Kërkesat dhe lutjet e Kristaqit drejtuar autoriteteve lokale për t’u mbështetur me bursë u pasuan nga heshtja. Gjithsesi, pavarësisht degës që i dhanë dhe vështirësive të mëdha ekonomike, ai i mbaroi studimet e larta me rezultate të shkëlqyera, me medalje ari.



Në vitet e studimeve në ILB Kamëz, me shokun e tij gjirokastrit, Hyzen Skënfuli



Vitet e punës

Pas mbarimit të studimeve, përmes një dokumenti lëshuar nga Instituti i Lartë Bujqësor Kamëz, sot Universiteti Bujqësor i Tiranës, vihet re se karakteristika e tij ndryshon ndjeshëm nga ajo me të cilën e përcolli qyteti i lindjes, përmes drejtorisë së gjimnazit katër vite më parë. Në karakteristikën që lëshoi Instituti Lartë Bujqësor thuhej: “Është shumë inteligjent dhe përpaket t’i shtojë njohuritë shkencore. Mund të punojë në çdo degë të bujqësisë, pasi është kuadër i përgatitur mirë.” Kjo bëri që ai të emërohet në Shkodër, një rreth bujqësor i rëndësishëm, me probleme të shumta e të mprehta në atë kohë, që kërkonin zgjidhje. Ministria e Bujqësisë e emëroi agronom në Seksionin e Bujqësisë të Komitetit Egzekutiv të këtij rrethi. Atje punoi me përkushtim për mbarëvajtjen e bujqësisë të këtij rrethi për tre vjet.

Në fillim të vitit 1960, transferohet në rrethin e Gjirokastrës. Fillon punë në ish-Fabrikën e Duhan-Cigareve. Kjo punë ishte e veçantë. Kërkonte të zgjidhje mirë linjat e proceseve teknike e teknologjike të grumbullimit, përpunimit e fermentimit të duhanit. Përveç kësaj Kristaqi ndiqte nga afër edhe kultivimin e duhanit nëpër ekonomitë bujqësore të rrethit, që nga kujdesi për farishtet, vjelja në kushte teknike dhe tharja e përpunimi i tij nëpër hangare.

Kur isha me punë agronom në ish-kooperativën bujqësore “Asim Zeneli”, rreth një muaj mbikqyrja dorëzimin e duhanit të kooperativës sonë në ish-Fabrikën e Duhan-Cigareve, për kontraditat që krijoheshin gjatë dorëzimit. Aty e njoha Kristaqin. Ishte shumë serioz në punë të cilën e bënte me pasion. Vërejta një teknologji fermentimi e përpunimi të duhanit si dhe një staf të mirëpërgatitur. Kur më pas isha inspektor i mbrojtjes së bimëve të rrethit, asistoj në dezinfektimet e përvitshme të duhanit dhe mjediseve të fabrikës, që kryhej ndaj dëmtuesve të duhanit. Kristaqi ishte gjithmonë në krye të punëve. Ky proces nuk lejonte gabimin më të vogël se ishte me pasoja të rënda.



Kristaqi gjatë punës në ish Fabrikën e Duhan-Cigareve

Puna në ish-Ndërmarrjen e Duhan-Cigareve siç përmenda më lart, kërkonte përgjegjësi, përgatitje shkencore e përkushtim. Kristaqi e përballonte me një punë e disiplinë shembullore e me orare të zgjatura. Për rezultatet e

PORTRET

Kristaq Kola - Agronom me diplomë të artë, por me “cen” në biografi

(Vijon nga faqja 11)

aritura, ai u bë shpesh edhe objekt i kronikave të mediave lokale dhe qendrore. Duhanit i kushtohej kujdes pasi ishte një e ardhur e mirë për ekonomitë bujqësore të rrethit Gjirokastrës. Mbilleshin rreth njëmijë ha e prodhoheshin rreth një mijë ton duhan në vit, vetëm në këtë rreth.

Ne vitin 1961 Kristaqi gjen shoqen e tij të jetës, mar-tohet me Angelina Papazisin nga lagjia “Varosh”. Lindën, rritën e edukuan tre fëmijë: Mimosën, Almën dhe Dritanin, të cilët kanë krijuar familjet e tyre.

Falë rezultateve të aritura, në vitin 1965 agronom



Kristaqi me familjen në Virua për festën e 1 Majit

Kristaqi emërohet kryeagronom dhe zv. shef i Seksionit Bujqësisë në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit. Edhe këtu punoi me përkushtim, por “ceni” në biografi i qëndronte si shpata e Demokleut mbi kokë. Në mënyrë paradoksale atmosfera e luftës së klasave, sikur po rikthehej në Gjirokastrë. Dosja e tij do të niste sërish nga faqja e parë ku me të kuqe ishte nënvizuar qëndrimi i familjes gjatë luftës dhe sigurisht më vonë dënimi me burg i babait të tij.

Si rrjedhojë e kësaj, pas një viti pune në Seksionin e Bujqësisë, në vitin 1966, u dërgua në ish-kooperativën

bujqësore “Partizani” të Lazaratit. Mësuesi dhe ish-drejtori i shkollës së mesme të Lazaratit, Zija Basha, e kujton kështu:

“Agronom Kristaq Kola mbahet mend në Lazarat si agronom i zoti, njeri i përsosur e punëtor i madh që i rinte punës përherë tek koka, me dituri e përkushtim. Që shumë komunikues me njerëzit e për çdo problem thoshte: “Ejani ta bejmë bashkë!” Dallohej puna e tij pasionante jo vetëm me duhanin, por dhe me kulturat e tjera bujqësore. Së bashku me agronomin tjetër, Orest Qirko, përgatitën teknikë për farishtet e duhanit e perimeve si dhe dhe teknikët në hangaret e duhanit që i duheshin kohës.

Unë kur punoja në ish Kooperativën Bujqësore “Asim Zeneli” vëreja se në sektorin e Lazarat kishte një staf shumë të përgatitur për farishtet e duhanit dhe perimeve si dhe teknikët e përpunimit të duhanit në hangare. Kjo tregonte se kolegët e mi paraardhës kishin punuar me përgjegjësi”.

Zija Basha gjithashtu kujton: “Unë agronom Kristaqin e njoh edhe si aktor të Teatrit të Gjirokastrës. Ruaj kujtimet më të mira për ditët që kalova me të në xhirimin e filmit “Malet me blerim mbuluar”, ku spikati edhe talenti i tij aktorial, në filmin e regjisorit Dhimitër Anagnosti.

Me sa duket ish-Fabrika e Duhan-Cigareve nuk bënte dot pa agronom Kristaqin, po dhe agronom Kristaqi pa fabrikën. E kthyen sërish në fabrikë. Me plot pasion dhe përkushtim vazhdoi në këtë ndërmarje punën që e la në mes. Agronomi Thanas Xhumba kujton: “Njohjen e parë me Kristaqin e pata në ish-Fabrikën e Duhan-Cigareve. Ishte një djalë i gjatë, simpatik dhe i sjellshëm. Ish-Kooperativa e Tipit të Lartë Grapsh, ku unë isha kryeagronom, mbillte shumë duhan, rreth 250-300 hektarë. Në ish-Fabrikën e Cigareve duhanin e dorëzonim gjatë vjeshtës. Shpesh teknikët tanë të duhanit kishin mosmarrëveshje me teknikët marrjes në dorëzim të fabrikës, për cilësinë, parametrat e lagështisë, kualitetin, etj. Jo rrallë makinat ktheheshin mbrapa pa e dorëzuar duhanin. Në këto raste ndërhynte Kristaqi për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Ai ishte komunikues e ndërhynte gjithmonë me takt e mirëkuptim, për t’i dhënë zgjidhje kontraditave që krijoheshin. Kristaqi kishte prirje edhe për aktrim por, njerëzit që merreshin më biografitë, vazhdonin të gërmonin. Sikur të mos mjaftonte babai, në biografi shtohet edhe dënimi për politikë i djalit të xhaxhait. Tani hijenat e biografive do ta sulmonin ndryshe. Dhjetë ditë përpara provës së përgjithëshme në teatër, e thirrën në drejtorinë e ndërmarjes për t’i komunikuar se duhet të ndërpriste provat me teatrin, pasi në fabrikë kishte shumë punë. Ky në fakt ishte vetëm preteksti. Dikush u rikujtua ta hapë edhe një



Në konferencat dhe seminarat shkencore që bëheshin për duhanin

herë nga faqja e parë dosjen e tij.

Plot pas 10 vjetësh, e rikthejnë edhe njëherë në kooperativën “Partizani” të Lazaratit. Ky “transferim” me sa u faktua më vonë, nuk ishte thjesht një qarkullim i zakonshëm kuadri që ndodhte rëndom në atë kohë. Për këtë njeri të zotin në punë dhe të apasionuar, thellë në skutat e errta dikush po përgatiste për Kristaqin një të ardhme tjetër, të ardhme të errët. Regjimi nuk jetonte dot pa armiq. Dhe aty ku armiku mungonte, ai e sajonte.

Përkushtimi i tij në punë dhe aftësia profesionale bënë që Kristaqi të rikthehet përsëri nga Lazarati në fabrikë, madje të vijojë të japë edhe mësim në shkollën teknologjike e cila ishte hapur për kualifikimin e puntorëve të saj.

Në vitin 2018, në kuadër të 50-vjetorit të themelimit të teatrit profesionist të Gjirokastrës ai u nderua nga Këshilli bashkiak me titullin “ Qytetar Nderi”, me këtë motivacion:

“Për kontributin e dhënë në lëvizjen e teatrove para dhe pas krijimit të Teatrit Profesionist të qytetit, duke u bërë një nga amatorët më të talentuar të tij. Intelktual dhe drejtues me vlera të spikatura që e nderon qytetin e Gjirokastrës.”

Pas gjithë këtyre përpjekjeve në punën e tij si agronom dhe aktor në teatër e kinema, i vëmendshëm ndaj njerëzve të dosjeve, pas rreth 40 vjet punë, në vitin 1998 del më pension. Nderroi jetë më 4 gusht të vitit 2008.

Rugëtimi përmes dosjes së Kristaq Kolës, nuk është një përrallë, por një e vërtetë e hidhur e të kaluarës.



Në kooperativën e Lazaratit



KËNDI I EKSPERTIT

Pamja e qiellit gjatë muajit mars 2025
Më 8 mars - Mërkuri në zg-jatimin më të madh lindor. Plan-eti Mërkuri arrin zgjatjen më të

Parashikimi i motit për muajin mars 2025 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	5	18	3/18/2018	28.2	10.5	7	4	JP	LJL	1	Vranësirë me ndonjë shi të rastit pasdite	
2	6	14	5/15/2014	0	0	7	6	VL	VVL	2	Re dhe kohë me diell	
3	5	15	6/14/2014	0	0	9	6	VL	VVL	3	Rikthim i vranësirës	
4	6	15	7/18/2015	0	0	7	4	VL	VVP	4	Pjesërisht me diell	
5	7	18	8/21/2018	0	0	6	4	JL	JJP	4	Kryesisht me diell	
6	8	18	8/20/2017	0	0	9	9	JL	J	4	Kohë me diell dhe pak re	
7	8	18	6/18/2018	0.5	1	9	7	LVL	VL	2	Intervali i reve dhe kohë me diell	
8	9	18	4/18/2017	2.6	2	15	13	L	L	4	Pjesërisht me diell	
9	8	16	7/13/2013	8.4	3.5	15	7	L	L	1	Vranësirë me disa shira, pastaj shi	
10	6	14	7/15/2013	0	0	9	4	VL	V	2	Kohë me re dhe diell	
11	6	17	8/20/2017	0	0	6	4	VL	VP	4	Pjesërisht me diell	
12	9	18	7/19/2019	12.4	6.5	4	6	JL	JL	1	Vranësira me reshje shiu dhe stuhi duke u bërë më e përhapur	
13	7	15	8/15/2014	0.6	1	11	6	LVL	VL	1	Një shi i vogël në mëngjes,pastaj vranësirë	
14	6	15	5/18/2014	0	0	7	6	JL	J	4	Diell	
15	8	17	5/17/2017	0	0	9	9	L	LVL	1	Vranësirë	
16	9	18	7/19/2017	1.7	1	15	11	LJL	JL	5	Pjesërisht me diell me ndonjë shi pasdite	
17	10	19	10/19/2018	0	0	13	4	L	VL	3	Intervali i reve dhe kohë me diell	
18	10	20	12/19/2018	1.3	1.5	9	4	LVL	V	2	Kryesisht vranësirë me ndonjë stuhi me pika	
19	10	19	11/18/2018	1	2	6	4	JJL	J	2	Kohëme re dhe diell me disa shira, kryesisht vonë	
20	9	19	8/22/2018	0	0	7	7	VL	V	5	Kohë me re dhe diell	
21	8	18	3/18/2016	11.9	6	15	13	LVL	LVL	3	Një shi në mëngjes, pastaj kohë me diell dhe re	
22	7	15	8/15/2015	2.3	2.5	9	2	VL	V	1	Vranësirë, dis shira në mëngjes të ndjekur nga shi vogël pasdite	
23	7	15	5/16/2016	7.5	4	7	4	LVL	V	3	Re dhe diell	
24	10	16	5/15/2014	19.2	10	13	11	LJL	JJP	1	Shi	
25	9	17	7/17/2015	9.6	4	17	11	JP	JJL	3	Disa shira në mëngjes dhe stuhi, pastaj kohë me re dhe diell	
26	9	16	5/15/2015	11	8	11	17	JL	J	1	Vranësirë	
27	10	16	5/15/2015	21	15	9	15	L	VL	1	Shi	
28	9	16	7/16/2016	6.5	5.5	11	9	VL	V	1	Shira të rastit	
29	8	16	9/19/2015	0	0	11	7	VL	VVL	4	Pas ikjes së reve, rikthehet dielli	
30	7	18	7/19/2018	0	0	7	7	VL	V	3	Kryesisht me re	
31	9	21	10/23/2020	0	0	9	9	V	VVL	6	Diell	

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit mars 2025

Treguesit	Tiranë	Korçë	Vlorë	Shkodër	Dibër	Gjirokastr
Temperatura e ajrit						
Mesatare (°C)	12	7	13	12	4	10
Maksimale (°C)	15	10	15	15	9	13
Minimale (°C)	9	4	11	9	0	6
Më e larta gjatë viteve (°C)	23 (2012)	20 (2017)	24 (2017)	24 (2012)	19 (2017)	22 (2017)
Më e ulta gjatë viteve (°C)	-2 (2010)	-9 (2011)	1 (2011)	-4 (2011)	-12 (2021)	-4 (2009)
Numuri i ditëve me Temperaturë + 30°C (Ditë dhe %)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0	0	0
Numuri i ditëve me Temperat në + 18°C (Ditë dhe %)	6 (19)	1 (3)	5 (16)	6 (19)	0	3 (10)
Numuri i ditëve me Temperat në -0°C (Ditë dhe %)	0 (0)	6 (19)	0	0	18 (58)	2 (6)
Temperatura e ujit në det						
Temperatura mesatare °C			15.1			
Temperatura minimale °C			14.3			
Temperatura maksimale °C			15.8			
Era						
Shpejtësia e erës (Km/Orë)	14	12	22	13	12	13
Temperatura e erës (°C)	8	2	10	7	-3	4
Reshjet (Shiu)						
Shi (mm)	194	137	169	229	201	204
Numuri i ditëve me shi (Ditë dhe %)	8 (26)	8 (26)	8 (25)	8 (26)	10 (31)	9 (31)
Sasia rekord e shiut gjatë një dite (mm dhe vit)	68.2 (2015)	60.1 (2021)	113.9 (2009)	139.1 (2013)	71.4 (2020)	80.2 (2018)
Dëborë (cm)	4.7	350.2	0	7.2	378.5	0.8
Lagështia e ajrit (%)	77	85	74	77	86	81
Shikueshmëria (Km)	9.36	8.21	9.48	9.17	8.23	9.02
Mbulimi i qiellit me re (%)	33	44	32	35	44	38
UV index	4	3	4	4	2	4
Orë me diell nëDitë	10	10	10	10	10	10
Gjatësia e ditës (Orë)	11:55	11:55	11:55	11:55	11:55	11:56
Vlerësimi i muajit	Mesatar	Shumë keq	Mesatar	Mesatar	Shumë keq	Mesatare



një pjesë të Diellit, ndonjëherë duke i ngjan një kafshimi të marrë nga një biskotë. Një eklips i pjesshëm diellor mund të vëzhgohet në mënyrë të sigurt vetëm me një filtër diellor të veçantë ose duke parë reflektimin e Diellit. Ky eklips i pjesshëm do të jetë i dukshëm në të gjithë Groenlandën dhe pjesën më të madhe të Evropës veriore dhe Rusisë veriore. Do të shihet më së miri nga Kanadaja me mbulim 93%.

Parashikimi i motit për muajin mars 2025

Marsi në Shqipëri do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Fraza që në thelb përshkruan më së miri motin në mars është se do të jetë muaj i lagësht. Kur udhëtoni në Shqipëri në muajin mars mund të prisni: herë pas here stuhi, zakonisht shi, herë pas here mjegull dhe mot freskues. Gama e temperaturave mesatare të ditës

do të jetë rreth 14°C dhe 21°C. Zakonisht java e tretë është më e nxehta në mars, por mbani mend shiun, mjegullën dhe stuhinë. Ngjarjet e motit që mund të ndodhin gjatë udhëtimit në Shqipëri: 5 herë Stuhi, 11 herë Shi, 2 herë Mjegull. Shqipëria në muajin mars do të përjetojë ditë të freskëta me qiell të vrenjtur. Në mënyrë tipike, temperatura do të luhatet rreth 17°C dhe do të ndihet për 16°C dhe era do të jetë fllad i lehtë.

Temperaturat e larta ditore do të rriten me 4°C, nga 14°C në 17°C, rrallë do të bien nën 9°C ose të kalojnë 22°C. Temperaturat e ulëta ditore do të rriten me 3°C, nga 2°C në 6°C, rrallë do të bien nën -3°C ose do të kalojnë 10°C.

Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18° C në 32° C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë

Kalendari bujqësor, muaji mars 2025

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Parashikimi i motit për mars 2025 në Korçë (Zona e ftohtë)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
